



**Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA V**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 50**

**Prishtinë, më 12.7.2016 në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jasmina Zhivković, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

**Munguan:** Agim Çeku, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha dhe Slavko Simiq.

**Pjesëmarrës të tjerë:** përfaqësuesi nga OSBE-ja, Senad Karaahmetović; përfaqësuese nga KDI-ja, Agnesa Haxhiu; gazetarë nga RTK-ja: Marija Trajković dhe Aleksandar Miladinović; konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 24.5.2016, 31.5.2016, 7.6.2016 dhe 8.6.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me Raport plotësues me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L 066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Arsimit, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L -088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L -108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;

7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L - 109 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;**
8. **Të ndryshme.**

#### **1. Miratimi i rendit të ditës.**

**Kryesuesja** theksoi se anëtarët e Komisioni e kanë marrë me kohë rendin e ditës së bashku me raportet e komisioneve funksionale dhe pyeti nëse pajtohen për miratim e të njëjtit.

**Myfera Sinik** ishte e mendimit që pika e katërt e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, pikë kjo që ka të bëjë me shqyrtimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL për Arsim lidhur me Projektligjin për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës, me arsye që i njëjti të shtjellohet në formë të detajuar.

Në bazë të propozimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës me ndryshimin që të shtyhet pika e katërt e rendit të ditës, Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L 066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, për datë 13.7.2016.

#### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 24.5.2016, 31.5.2016, 7.6.2016 dhe 8.6.2016;**

**Kryesuesja**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 24.5.2016, 31.5.2016, 7.6.2016 dhe 8.6.2016, pa vërejtje.

#### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me Raport plotësues me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale**

**Kryesuesja** paraqiti për shqyrtim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raport plotësues dhe amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit plotësues me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:*

#### **Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

**4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L -088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

**Kryesuesja** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L -088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

*Meqë nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:*

**Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L -088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L -108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.**

**Kryesuesja** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L -108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

*Meqë nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:*

**Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L -108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

**6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L - 109 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa**

**Kryesuesja** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L - 109 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë sugjerim apo vërejtje.

Duke pasur parasysh faktin se shqyrtimi i këtij projektligji duhet të bëhet me procedurë të përsheptuar, andaj obligohemi t'i respektojmë afatet kohore. Gjegjësisht, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë sugjerim apo propozim konkret.

**Myfera Sinik** ishte e mendimit që Komisionit të përkrah amendamentin e propozuar nga Qerim Bajrami, nën ky që ka të bëjë me kodin organizativ në kategorinë për paga dhe mëditje, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prizrenit.

**Qerim Bajrami** tha se me kohë e ka proceduar amendamentin në Komisionin për Buxhet dhe Financa por i njëjti nuk ka marrë aprovimin nga ky Komision.

Ai citoi tekstin e propozim amendamentit;

Tabela 3.1 Buxheti i rishikuar i nivelit qendror

Nga Organizata buxhetore ‘ Universiteti i Prishtinës ‘ kodi organizativ – 242 nga kategoria ekonomike ‘Mallra dhe Shërbime’ zvogëlohet shuma prej 50.000 euro dhe transferohet në organizatën buxhetore ‘ Universitetit në Prizren’ – kodi organizativ 0941 në kategorinë ekonomike ‘ Paga dhe mëditje’.

Propozimi i tij ishte që Komisioni të përkrahë amendamentin 17, me qëllim që të dalim me rekomandim i cili do të procedohet për votim në Komisionin Funkcional, ndërsa për shqyrtim të mëtejme do të diskutohet edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

**Agim Kikaj** theksoi se me përpikëri ka analizuar amendamentin e dhënë nga Qerim Bajrami dhe sipas vlerësimit të tij është e domosdoshme që të rregullohet me ligj ndarja buxhetore për komunitetet. Gjegjësisht, ofron përkrahje të plotë që Komisioni të dalë me rekomandim konkret.

**Sasha Milosavljeviq** nuk e parasheh të arsyeshme se cilat amendamente janë përkrahur nga Komisioni Funkcional. Ai mbështet propozim amendamentin e deputetes, Emilja Rexhepi dhe të kolegut Bajrami.

**Danush Ademi** tha se vota e deklaruar në Komision duhet të mbrohet njëjtë edhe në Kuvend. Ai përkrahu propozimin e **Veton Berishës**, kur bëhet fjalë për çështje madhore. Ne jemi të obliguar të veprojmë në bazë të parimeve që marrin në grupet parlamentare.

Paraqiti shqetësimin e tij lidhur nën 10, të ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi ende nuk është krijuar strategjia për implementimin e këtij neni, gjë që paraqet zhgënjim të madh për komunitetin jo shumicë.

Kërkoj të marrë përkrahjen e Komisionit lidhur me tri çështje. E para, Komisioni është në procedurë të monitorimit të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe se gjatë takimeve me përfaqësues në institucione janë marrë përgjigje se ekziston vullneti i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve, mirëpo MF deri më sot nuk ka paraparë ndarje buxhetore, për këtë kategori. Lidhur me këtë çështje kërkoj të informohet për mënyrën e procedimit të një neni, i cili do të obligojë MF të sigurojë fonde për paga dhe mëditje, me ç’ rast rritet numri i të punësuarve të përkatësisë së komunitetit jo shumicë, në administratë publike.

Nën dy propozoi që ministri i Arsimit, të parashohë një linjë të veçantë buxhetore në ndarjen e bursave për studentët e komuniteteve, në Universitetet e Kosovës.

Si çështje tjetër, premtimi i dhënë për ndarjen buxhetore në ndërtimin e rrugëve, nuk është realizuar deri më sot.

Ndoshta jemi të vonuar për procedimin e çështjeve të lartcekura, pasi këto ditë jemi në periudhën e votimit të Ribilancit Buxhetor për vitin 2016, në Kuvend.

Ishte kritik se çështjet e përfaqësimit të komuniteteve duhet të shtjellohen në fillim të leximit të parë të Projektligjit për Buxhetin vjetor.

**Danush Ademi** tha se nuk e shoh të arsyeshme të dalim me amendament të ri, pasi në Kuvend kemi marrë votat e mjaftueshme për kodin buxhetor, në vlerë prej 100.000 E. Ne presim sqarime për mos zbatimin e kodit, të miratuar me Ligjin për Buxhetin e Kosovës, për vitin 2016.

Kritikat i takojnë ministrit për Komunitete dhe Kthim, i cili nuk ka paraparë plan të veprimit lidhur me kërkesat tona, siç janë: asfaltimi i rrugëve dhe hapja e tre bunarëve.

**Agim Kikaj** theksoi se kërkesat e parashtruara nga parafolësit nuk kanë vend në këtë kohë, sepse buxheti është votuar në fillim të vitit, kurse sot jemi të thirrur vetëm në shqyrtimin e ribilancit buxhetor, për vitin 2016. Ne mund të kërkojmë nga zyra e Kryeministrit dhe ministrit e linjës, që ata të ofrojnë sqarime shtesë lidhur me projekt-programet e realizuara në emër të komuniteteve.

Kryesuesja konsideron se Komisioni ka për obligim të shqyrtojë vetëm ribilancin e buxhetit për vitin 2016. Sa i përket kërkesave të dala nga kolegët janë me vend, por këshilla e saj ishte se propozimet duhet të jenë konkrete dhe të hartohen mirë, me qëllim që të procedohen me kohë dhe në adresë të duhur.

*Në bazë të diskutimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Komisionit funksiona t'i paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

Komisioni rekomandon propozimin për ndryshim, si vijon:

#### **Amendamenti 1**

Tabela 3.1 Buxheti i rishikuar i nivelit qendror:

Nga Organizata buxhetore „Universiteti i Prishtinës”, kodi organizativ - 242, nga kategoria ekonomike „Mallra dhe shërbime” zvogëlohet shuma prej 50.000 € dhe transferohet në organizatën buxhetore „Universiteti në Prizren”- kodi organizativ 0941 në kategorinë ekonomike „Paga dhe mëditje”.

### **Arsyetim**

Këto mjete shtesë janë të domosdoshme për shkak të punësimit të 5-6 profesorëve të rinj universitarë –bashkëpunëtorë (ligjërues), për hapjen e degës së re në gjuhën boshnjake në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prizrenit.

1. Kjo degë është dashur të hapet në vitin akademik 2015/2016, mirëpo nuk është realizuar kjo nismë për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, sipas marrëveshjes zyrtare të Rektoratit dhe të rektorit të Universitetit në Prizren, sipas kërkesës zyrtare të përfaqësuesve të komunitetit Boshnjak të Kosovës, e cila i është drejtuar në gjysmëvjedorin e parët të vitit 2015 .
2. Ekziston nevojë shumë e madhe për hapjen e kësaj dege të re e cila – me lejimin e mjeteve – do të hapet në vitin akademik 2016/2017. Me këtë do të përmirësohet mundësia e studimeve të boshnjakëve të Kosovës, të cilët më së shumti gravitojnë në rajonin e Prizrenit, dhe se janë drejtuar për studime në fakultetet e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, i cili në një pjesë të mirë është Universitet shumëgjuhësh.

Vërejtje:

1. Aprovimi i këtij amendamenti është premtuar nga ana e ministrit të Financave, z. Abdullah Hoti dhe ministri për Arsim, z. Arsim Bajrami.
2. Shpenzimet për transferim mund të sigurohen edhe prej vijës tjetër buxhetore.

## **6. Të ndryshme**

**Kryesuesja** i njoftoi anëtarët e Komisionit, se me datë 13.07.2016 është ftuar në takim Shkëmb Manaj, kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me implementimin nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nen ky që rregullon çështjen e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, në shërbimin civil të vendit.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:00.**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

---

**Jasmina Zhivković**